



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.13.dt.03.03.2000

**PER
MIRATIMIN E BUXHETIT TE BASHKISE SE TIRANES PER VITIN 2000**

Këshilli i Bashkisë i Tiranës i mbledhur sot më datë 03.03.2000 pasi mori në shqyrtim relacionin e Drejtoria e Financës “Për miratimin e buxhetit të vitit 1999 dhe planin e buxhetit të vitit 2000”, mbështetur në ligjin 7776 dt.22.12.1993 neni 5 “Për Buxhetin Lokal”, ligjit 7572 dt.10.06.1992 neni 14 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre

V E N D O S I

1. Të miratojë realizimin e buxhetit të vitit 1999 (sipas pasqyrave bashkangjitur)
2. Të miratohet në tërësi buxheti i vitit 2000 (sipas pasqyrave bashkangjitur)
 - Nuk miratohet fondi në zërin Ndërtim Banesa pasi është i papërfillshëm dhe të kërkohet plotësimi me fond për trajtimin e të pastrehëve me akt-marveshje
 - Investimet miratohen ato që janë dhe lihen të hapura për shtesë në zërat sistemim, asfaltim, riparim ujësjellësi dhe ndërtim KUZ
3. Të miratojë limitin e përdorimit të të ardhurave për vitin 2000 në masën 455 milion lekë të ndarë sa vijon:
 - a) për shpenzime operative në masën 455 milion lekë dhe detajimin e tij sipas drejtorive:

Drejtoria Zhvillimit Ekonomik	62.000 mijë lekë
Drejtoria Përgj P.P e Shërbimeve	105.000 mijë lekë
Drejtoria Shënd. E Mjedisit	40.000 mijë lekë
Drejtoria Përgj. Org.Pers. e Shërb	60.000 mijë lekë
Drejtoria Kult. Arsim	15.000 mijë lekë
Drejtoria Sporteve	8.000 mijë lekë
Fonde të padetajuara	15.000 mijë lekë

b) për investime 150 milion lekë, sipas pasqyrës bashkangjitur

4. Ndryshimi i destinacionit të fondeve buxhetore nga artikulli 03 dhe 09 për çdo institucion të bëhet me miratim të Drejtorisë së Financës sipas kërkesave të ndërmarrjeve dhe institucioneve të konfirmuara nga Drejtoritë e Bashkisë
5. Për investimet nga të ardhurat që do të bëhen shtesë në buxhetin e vitit 2000, 14% e tyre do të jenë për Sektorin e Kulturës, Arsimit, Shëndetësisë dhe Veterinarisë
6. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoritë e tjera të Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

ORHAN SAKIQI

